



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

RAPORT PËRMBLEDHËS TAKSAT MJEDISORE NË KOSOVË 2022-2023

Prishtinë, Korik 2024

PËRMBLEDHJE E INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Sipas raportit të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi rezultatet e hulumtimit të "Taksave Mjedisore" për vitet 2022-2023, të ardhurat nga taksat mjedisore në vitin 2022 arritën në 314,122.9 milionë euro, ndërsa në vitin 2023 këto të ardhura u rritën në 340,337.3 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 8.3% krahasuar me vitin e kaluar.

Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për taksat mjedisore në Kosovë. Taksat mjedisore shërbejnë si instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi statistikor është të ofrojë të dhëna statistikore për taksat mjedisore për të gjithë kategoritë e përdoruesve të të dhënave statistikore në Kosovë, si dhe të monitorojë vazhdimisht taksat mjedisore dhe të raportojë në Eurostat.

Në këtë publikim, taksat mjedisore janë paraqitur në formë të përmbledhur, duke përfshirë taksat e transportit, taksat e ndotjes dhe taksat e energjisë-akciza.

Sipas strukturës së të ardhurave nga taksat mjedisore për vitin 2023, taksat e energjisë përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave me 298,557.8 milionë euro, ose 87.7%. Pasohen nga taksat e transportit me 40,479.6 milionë euro, ose 11.9%, dhe taksat e ndotjes me 1,299.9 milionë euro, ose 0.4%.

Mund të themi se gjatë viteve 2022-2023, të ardhurat nga taksat e energjisë përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave nga taksat mjedisore, duke përbërë 86.6% të totalit në vitin 2022 dhe rreth 87.7% në vitin 2023. (Taksat Mjedisore në Kosovë, 2024).

TAKSAT MJEDISORE NË KOSOVË, 2022-2023

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të ardhurat nga taksat mjedisore në Kosovë për periudhën 2019-2023, të ndara në tre kategori kryesore: taksat e energjisë (akciza), taksat e transportit dhe taksat e ndotjes në million euro.

Në përgjithësi, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën 340,337.3 milionë euro në vitin 2023, me taksat e energjisë që përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave, ndërsa taksat e transportit dhe ndotjes kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme.

Tabela 1 Të ardhurat nga taksat mjedisore sipas llojeve (milionë euro)

	2019	2020	2021	2022	2023
Taksat e Energjisë (Akciza)	251,141,783	236,828,087	289,318,140	271,988,917	298,557,860
Taksat e Transportit	35,572,192	34,906,825	39,828,802	40,921,820	40,479,562
Taksat e Ndotjes	1,158,160	1,111,687	1,827,754	1,212,194	1,299,866
Gjithsej	287,872,135	272,846,599	330,974,696	314,122,931	340,337,288

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 2 Struktura e të ardhurave nga taksat mjedisore sipas llojeve, në %

Në tabelën dy kemi strukturën e të ardhurave nga taksat mjedisore në përqindje ku mund të themi se të ardhurat nga taksat e energjisë përbejnë pjesën më të madhe të të ardhurave me 87.7% në vitin 2023, taksa e transportit 11.9% dhe taksa e ndotjes me 0.4%.

	2019	2020	2021	2022	2023
Taksat e Energjisë (Akciza)	87.2	86.8	87.4	86.6	87.7
Taksat e Transportit	12.4	12.8	12.0	13.0	11.9
Taksat e Ndotjes	0.4	0.4	0.6	0.4	0.4
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Figure 1 Paraqitja grafike e taksave mjedisore (milionë euro)

Figura 1 paraqet të ardhurave nga taksat mjedisore në Kosovë për vitet 2019-2023 në milionë Euro të ndara në tre kategori kryesore: taksat e energjisë (akciza), taksat e transportit dhe taksat e ndotjes.

Taksat e Energjisë (Akciza)¹: Përqindja e të ardhurave nga taksat e energjisë ka mbetur e qëndrueshme nga viti 2019 deri në vitin 2022 me rreth 87%, dhe në vitin 2023 ka arritur 88%, ky stabilitet tregon se taksat e energjisë janë burimi kryesor i të ardhurave nga taksat mjedisore gjatë gjithë periudhës së paraqitur.

Taksat e Transportit²: Përqindja e të ardhurave nga taksat e transportit ka qenë afërsisht rreth 12.6% në vitet 2019, 2021 dhe 2022 ndërsa në vitin 2023, kjo përqindje është ulur në 11.9%, ky trend tregon një kontribut relativisht të qëndrueshëm të taksave të transportit në të ardhurat totale nga taksat mjedisore.

Taksat e Ndotjes: Taksat e ndotjes përfshijnë emetimet e matura në ajër dhe shkarkimet në ujë, menaxhim të mbetjeve të ngurta dhe zhurmës etj. Përjashtohen këtu tatimi mbi emetimin e CO₂, i cili mbulohet nga kategoria taksave të energjisë. Taksat e ndotjes kanë një kontribut minimal në të ardhurat totale nga taksat mjedisore dhe janë fare të vogël krahasuar me dy kategoritë e tjera. Për vitet 2019, 2020 dhe 2022, kjo pjesëmarrje sillej në rreth 0.4%, përjashtim bënë në vitin 2021, duke shënuar rritje në 0.6%.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

¹ Taksat e Energjisë (Akciza), kryesisht mbildhet me rastin e importit të mallrave (si naftës dhe derivatet e naftës e të ngjashme) importi i mallrave të Kapitulli 27-Lendet djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre; substancat bituminoze; dyllët minerale.

² Taksat e Transportit (me përjashtim karburantit e makinave) i referohen kryesisht taksave të lidhura me pronësinë dhe përdorimin e automjeteve.


Tabela 3 Pjesëmarrja e taksave mjedisore sipas Bruto Produkti Vendor (BPV) në %

Nga tabela 3 vërehet se përqindja e të ardhurave tatimore nga taksat mjedisore në raport me gjithsej Bruto Produkti Vendor (BPV), ndër vite ka pasur një luhatje të lehtë, e ndjekur nga një rënie dhe stabilizim në dy vitet e fundit 2022 dhe 2023.

Viti	2019	2020	2021	2022	2023
Taksat	4.08	4.03	4.16	3.53	3.53

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Figure 2 Pjesëmarrja e taksave mjedisore në gjithsej Bruto Produkti Vendor (BPV) në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org